



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 636 Akti**

**Nr. 813 Vendimi**  
**Tiranë, më 11.11.2024**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Olsi Komici</b>	Kryesues
<b>Firdes Shuli</b>	Relatore
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Anëtare

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 11.11.2024, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Zamira Vyshka**, ish-gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.**

**Ligji nr. 84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Ligji nr. 96/2016** “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015** “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017**, i Gjykatës Kushtetuese.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument shkresor, bisedoi çështjen në tërësi, bazuar në vlerësimin tërësor të procedurave, sipas pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit nga viti 1993 e në vazhdim ka ushtruar detyrën si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Zamira Vyshka është subjekt i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.
2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: (i) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31-33 të ligjit nr. 84/2016; (ii) Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK), sipas neneve 34-39 të ligjit nr. 84/2016; (iii) Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ) sipas neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016.
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, është zhvilluar shorti në datën 15.12.2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Zamira Vyshka do t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Olsi Komici, Firdes Shuli dhe Valbona Sanxhaktari. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Firdes Shuli.
4. Me vendimin nr. 1, datë 15.1.2021, trupi gjykues filloi hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, caktoi kryesues komisionerin Olsi Komici dhe deklaroi mungesën e konfliktit të interesit. Me *email* të datës 10.2.2021 subjekti deklaroi mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Në datën 26.2.2021, subjekti paraqiti pranë Komisionit përgjigjet e pyetësorit standard, së bashku me dokumentacionin.

### II. RRETHANAT DHE FAKTET LIDHUR ME ÇËSHTJEN

5. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit Zamira Vyshka ka nisur *ex officio* dhe subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dorëzuar në ILDKPKI deklaratën e pasurisë *Vetting*. Ndërsa procedura administrative për kryerjen e këtij procesi nga Komisioni ka filluar me hedhjen e shortit në datën 15.12.2020. Në vijim, gjatë procesit të hetimit administrativ në lidhje me subjektin e rivlerësimit u konstatuan faktet si vijon:
6. SPAK-u<sup>1</sup> informoi se në datën 28.7.2021 është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\* për veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç, në ngarkim të shtetasës Zamira Vyshka etj. Pas përfundimit të hetimeve në lidhje me këtë procedim, është vendosur dërgimi në gjyq me kërkesën për gjykim, datë 19.1.2023, në ngarkim të shtetasës Zamira Vyshka për veprën penale të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal. Ky procedim është në fazën e gjykimit në seancë paraprake dhe nga dokumentet shkresore të përcjella rezultoi se: (i) me vendim për njoftimin e akuzës, datë 27.12.2022, SPAK-u ka marrë të pandehur shtetasen Zamira Vyshka, duke e akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal; (ii) me kërkesën e datës 19.1.2023, SPAK-u ka kërkuar dërgimin e çështjes në gjyq kundër së pandehurës Zamira Vyshka për veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç etj.

<sup>1</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.3.2023, të SPAK-ut, në dosjen e Komisionit.

7. KLGJ-ja<sup>2</sup> informoi se me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.7.2022, të KLGJ-së, znj. Zamira Vyshka është pezulluar nga detyra e magjistrates pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për shkak të masës së sigurimit personal “Arrest në shtëpi”, caktuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.7.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

8. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar<sup>3</sup> vuri në dispozicion të Komisionit:

i) vendimin nr. \*\*\*, datë 4.7.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas të cilit është vendosur deklarimi fajtor i të pandehurës Zamira Vyshka për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 3 vjet burgim etj.;

ii) vendimin nr. \*\*\*, datë 26.1.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas të cilit është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. \*\*\*, datë 4.7.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

9. KLGJ-ja<sup>4</sup> vuri në dispozicion të Komisionit vendimin nr. \*\*\*, datë 29.5.2024, për caktimin e masës disiplinore ndaj gjyqtarës Zamira Vyshka, vendim i cili, mbështetur në nenin 147, pika 1, nenin 147/a, pika 1, shkronja “b” dhe nenin 140, pika 2, shkronja “b”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 146, pika 2, shkronja “b” dhe nenin 157 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 86, shkronja “e” dhe nenin 97, pika 1, shkronja “a” dhe pika 3, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe në nenin 104 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, ka vendosur: *1. Pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. 2. Shkarkimin nga detyra të magjistrates, znj. Zamira Vyshka, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. 3. Ndërprerjen e marrëdhënieve financiare, të pagës, si dhe të përfitimeve të tjera të magjistrates Zamira Vyshka. 4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese, afat i cili fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar. 5. Një kopje e vendimit të arsyetuar t’u njoftohet subjekteve të procedimit disiplinor, magjistrates Zamira Vyshka dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

9.1 KLGJ-ja gjithashtu informoi se me shkresën nr. \*\*\*, datë 25.6.2024, vendimi i arsyetuar i është përcjellë znj. Zamira Vyshka dhe se nga shërbimi postar rezulton se shkresa ka mbërritur tek ajo në datën 26.6.2024.

10. Nga verifikimi në sistemin e Gjykatës së Lartë<sup>5</sup> rezulton se me vendimin e datës 17.10.2024 ka vendosur prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 26.1.2024, të Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

11. Në datën 21.10.2024, me anë të postës elektronike, subjektit iu dërgua pyetësori nr. 2, duke i lënë një afat për kthimin e përgjigjes brenda një afati 10-ditor. Në datën 22.10.2024, subjekti është shprehur: *“Në lidhje me sa sipër, ju informoj se nga data 1.6.2024 unë kam dalë në pension dhe e kam humbur statusin e magjistrates. Për këtë qëllim, ju vë në dispozicion*

<sup>2</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2023, të KLGJ-së, në dosjen e Komisionit.

<sup>3</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.2.2024 dhe nr. \*\*\* prot., datë 29.3.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

<sup>4</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.6.2024 dhe nr. \*\*\* prot., datë 2.10.2024, të KLGJ-së.

<sup>5</sup> [https://gjykataelarte.gov.\\*\\*\\*](https://gjykataelarte.gov.***)

vërtetimin datë 21.10.2024 të DRSSH-së”. Sipas vërtetimit datë 21.10.2024 të ISSH-së bashkëngjitur, rezulton se znj. Zamira Vyshka përfiton pension suplementar/pleqërie që në datën 1.6.2024. Në vijim, me email të datës 22.10.2024, Komisioni i kërkoi subjektit të vërtetojë me dokument Humbjen e statusit të magjistratit dhe po në të njëjtën datë me anë të postës elektronike subjekti u shpreh se: *“Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informoj se me vendimin nr. \*\*\*, datë 29.5.2024, të KLGJ-së, është vendosur shkarkimi nga detyra i magistrates Zamira Vyshka; ndërprerja e marrëdhënieve financiare, të pagës, si dhe të gjithë përfitimeve të tjera. Ndaj këtij vendimi nuk kam bërë ankim.”* Me mbarimin e afatit të caktuar, subjekti nuk ka kthyer përgjigje për pyetësonin nr. 2.

### **Në lidhje me vendimin nr. \*\*\*, datë 29.5.2024, të KLGJ-së**

**12.** Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. \*\*\*, datë 29.5.2024, për caktimin e masës disiplinore ndaj gjyqtarës Zamira Vyshka, është një akt administrativ individual, i cili është i ankimueshëm sipas parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, konkretisht:

**12.1** Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë. Sipas nenit 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të individëve. Sipas nenit 179, pika 7 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, juridiksionin disiplinor kundër vendimeve të Këshillit të Lartë të Gjyqësor gjatë mandatit 9-vjeçar e ushtron Kolegji i Posaçëm të Apelit.

**12.2** Sipas nenit 147 të ligjit nr. 96/2016, magjistrati dhe inspektori kanë të drejtë të ankimohen vendimin për masë disiplinore në gjykatën kompetente. Sipas nenit 100 të ligjit nr. 115/2016, aktet administrative individuale që vendosin masa disiplinore mbi gjyqtarët ankimohen në Gjykatën Kushtetuese. Sipas pikës 3/b të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve. Pra, ankuesi nuk ka mjet tjetër ligjor ankimi, përveç kërkesës drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

**12.3** Sipas nenit 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese (Kolegji), kur kërkesa paraqitet brenda afatit 4-mujor nga konstatimi i cenimit, afat i cili sipas vendimit nr. \*\*\*, datë 29.5.2024, të KLGJ-së, fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar, njoftim të cilin subjekti e ka marrë në datën 26.6.2024.

**12.4** Kolegji, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.11.2024, informoi se në regjistrin e çështjeve në kuadër të juridiksionit disiplinor nuk është regjistruar ankim nga znj. Zamira Vyshka kundër vendimit nr. \*\*\*, datë 29.5.2024, të KLGJ-së.

**12.5** KLGJ-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.11.2024, në lidhje me vendimin nr. \*\*\*, datë 29.5.2024, të KLGJ-së, konfirmoi se në bazë të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, znj. Vyshka nuk ka ushtruar ankim sipas afateve ligjore. Si rrjedhojë, vendimi i shkarkimit të saj ka marrë formë të prerë dhe se, referuar nenit 64, shkronja “ç” e ligjit nr. 96/2016, statusi i magjistratit mbaron (edhe) kur shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimit të këtij ligji. Si rrjedhojë, rezulton se znj. Zamira Vyshka nuk gëzon më statusin e magjistratit.

### III. VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR I ÇËSHTJES

13. Sipas parashikimeve të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, subjekti Zamira Vyshka i nënshtrohet procesit të rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni në bazë të nenit 179/b, pika 5<sup>6</sup> e Kushtetutës.

14. Sipas shkronjës “ç” të pikës 1 të nenit 64 të ligjit nr. 96/2016, statusi i magjistratit mbaron në rastet kur shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji.

15. Sa më sipër, sa i përket situatës faktike, konstatohet se gjatë procesit të hetimit administrativ subjekti i rivlerësimit është shkarkuar nga detyra nga KLGJ-ja. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur ankim ndaj vendimit të KLGJ-së për shkarkimin nga detyra brenda afateve ligjore. Në këtë mënyrë, vendimi i KLGJ-së nr. \*\*\*, datë 29.5.2024, për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, është i formës së prerë, duke sjellë si pasojë mbarimin e statusit të magjistratit, fakte këto të konfirmuara edhe nga organet kompetente.

16. Në analizë të dispozitave kushtetuese dhe atyre ligjore, humbja e statusit të magjistratit sipas parashikimeve ligjore passjell edhe humbjen e statusit të subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, kjo situatë faktike/ligjore bën që procesi i rivlerësimit, i cili synon rivlerësimin e subjekteve, të mbetet pa objekt. Nisur nga legjislacioni i zbatueshëm dhe fakti që aktualisht subjekti nuk ka statusin e magjistratit, konstatohet se objekti për të cilin ka nisur procedura e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Zamira Vyshka është bërë i pamundur.

17. Ndodhur para një situatë faktike dhe ligjore si më lart, zhvillimi i procesit administrativ i nisur nga Komisioni për rivlerësimin e subjektit Zamira Vyshka bazohet në:

i) pikën 6, neni 4 i ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: *“Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji”.*

ii) nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, i cili parashikon se: *“Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.”*

18. Sa më sipër arsyetuar, trupi gjykues arrin në përfundimin se mbarimi i statusit të magjistratit sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative të rivlerësimit kalimtar pa një vendim përfundimtar.

### PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në shkronjën “ç” të pikës 1 të nenit 64 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar,

### V E N D O S I:

---

<sup>6</sup> Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese.

1. Të deklarojë të përfunduar pa një vendim përfundimtar procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Zamira Vyshka, ish-gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, pasi objekti për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur për shkak se subjekti i rivlerësimit ka humbur statusin e magjistratit.
2. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 11.11.2024.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Olsi KOMICI**  
**Kryesues**

**Firdes SHULI**  
**Relatore**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Jonida Vrana*